



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA - VUSHTRRI



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 të “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës pas konsultimit me Kryesuesin e Komitetit për Politik dhe Financa, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim përcaktohet realizimi i planit të veprimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit të Komunës dhe projekteve prioritare për vitin 2014 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Në kuadër të këtij plani të veprimit caktohet data dhe vendi i mbajtjes së takimeve publike me qytetar ku do të bëhet dëgjimi publik i buxhetit të komunës dhe diskutohen propozimet për projektet prioritare për vitin 2014.
3. Për këtë qëllim formohen grupet punuese në teren për mbarëvajtje të dëgjimit publik si vijon:
 - **Më 20.06.2013 në ora 18:00 në Stroc** (në shkollën e fshatit) Habib Mustafa, Mexhit Përçuku, Nezir Klinaku, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 20.06.2013 në ora 18:00 në Druar** (në shkollën e fshatit) Abit Abiti, Bajram Beqiri, Xhevrije Rama, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 20.06.2013 në ora 18:00 në Novolan** (në shkollën e fshatit) Isuf Jashari, Qerim Selimi, Dr. Safet Idrizi, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 20.06.2013 në ora 20:00 në Pantinë** (në shkollën e fshatit) Fadil Muzaqi, Idriz Ismajli, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 21.06.2013 në ora 20:00 në Smrekonicë** (në shkollën e fshatit) Isuf Jashari, Nasuf Aliu, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 21.06.2013 në ora 18:00 në Samadrexhë** (në shkollën e fshatit) Mexhit Perçuku, Qerim Selimi, Bajram Beqiri, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.

- **Më 21.06.2013 në ora 20:00 në Maxhunaj** (në shkollën e fshatit) Mexhit Perçuku, Qerim Selimi, Bajram Beqiri, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 21.06.2013 në ora 18:00 në Skromë** (në shkollën e fshatit) Sami Istrefi, Idriz Muzaqi, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 24.06.2013 në ora 18:00 në Dumnicë e mesme** (në shkollën e fshatit) Sami Istrefi, Dibran Përçuku, Naim Hyseni, Isuf Jashari, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 24.06.2013 në ora 20:00 në Stanoc i epërm** (në shkollën e fshatit) Sami Istrefi, Dibran Përçuku, Naim Hyseni, Isuf Jashari, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane përfaqësuesi i KPF-së.
 - **Më 24.06.2013 në ora 18:00 në Prelluzhë** në ZLK, Bojana Artitanoviq, Milan Kostic, këshillat e fshatrave me qytetarë të kësaj ane, përfaqësuesi i Buxhetit të Komunës.
 - **Më 24.08.2012 në ora 11:00 në QK "Hasan Prishtina"** - Vushtrri: Kryetari i Komunës, qytetarët, përfaqësuesi i KPF dhe drejtorët e drejtorive.
4. Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa në marrëveshje me anëtarët e këtij komiteti do të caktoj nga një anëtar të KPF-së për secilin dëgjim publik në teren.
 5. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që të siguroj automjetet zyrtare të nevojshme të komunës për zyrtarët të cilët do të marrin pjesë në këto takime.
 6. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të përgatisë raport për secilin fshat lidhur me obligimet e kryera dhe të pakryera të tatimit në pronë – të prezantohet raporti para qytetarëve të atij fshati me rastin e diskutimit të buxhetit dhe planifikimit të projekteve prioritare, duke dhënë shpjegime se pagesat e tatimit në pronë do të jenë barometër për investime në projekte kapitale në të ardhmen në territorin e komunës.
 7. Obligohet Kryesuesi i secilit takim publik që të siguroj procesmbajtësin i cili do të përfshijë në procesverbal kërkesat e parashtruara nga qytetarët në atë takim.
 8. Procesverbalet nga të gjitha takimet publike të dorëzohen: nga një ekzemplarë në Drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe në Sekretarinë e KK-së.
 9. Me këtë vendim njoftohen: të gjithë bartësit e aktiviteteve të cekur më lartë si dhe zyra për informim e komunës e cila do të bëjë publike në mjetet e informimit publik orarin e mbajtjes së këtyre takimeve.

Kryetari i Komunës
Bajram Mulaku